



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 87
Prishtinë, më 16 e 22 nëntor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 16 DHE 22 NËNTOR 2012**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan **Xhavit HALITI** dhe **Enis KERVAN**, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Nait Hasani, Armend Zemaj, Visar Ymeri, Burim Ramadani, Nijazi Idrizi, Haki Demolli, Arsim Bajrami, Albana Gashi, Rasim Demiri, Ali Sadriu dhe kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Para se të procedohet me pikat e tjera të rendit të ditës, Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së, propozoi që pika e 6-të të radhitet si pikë e 3-të e rendit të ditës.

Kryetari kërkoi deklarinimin e deputetëve për propozimin e kryetarit të GP të LDK-së.

Kuvendi me shumicë absolute e miratoi propozimin e Ismet Beqiri që shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës të radhitet si pikë e tretë e rendit të ditës.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

2. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e dytë të zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës,
8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

2. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. HashimThaçi, për takimin e dytë të zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë

Kryetari i njoftoi deputetët se kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, ka shprehur gatishmërinë për ta informuar Kuvendin për takimin e tij të dytë me kryeministrin e Serbisë, në Bruksel.

Ai e ftoi Kryeministrin që ta marrë fjalën.

Kryeministri i Kosovës, z. **Hashim Thaçi**, tha se në përputhje me Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës e informoj Kuvendin dhe qytetarët e Kosovës për takimin e dytë të zhvilluar në Bruksel ndërmjet meje si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me ndërmjetësimin e baroneshës Eshton, me kryeministrin e Serbisë, zotin Daçiq.

Më 7 nëntor, në Bruksel, u mbajt takimi i dytë i radhës, në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Në takimin e dytë kemi shënuar progres konkret, sidomos në çështjen e zbatimit në praktikë të Marrëveshjes teknike për menaxhimin e integruar të kufirit.

Çështjet që janë diskutuar në takimin e dytë janë:

Si pikë e parë, çështja e **personave të zhdukur**, që vazhdon të mbetet një problem shumë i dhembshëm. Kjo është çështje është ngrehur nga unë dhe do të vazhdojë të ngrihet vazhdimisht, derisa të përmbyllet ky proces.

Jemi pajtuar që të intensifikohen takimet e grupeve punuese të ndërsjella për gjetjen dhe zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Unë në këtë rast kam kërkuar nga Komisioni Qeveritar i Republikës së Kosovës që të jetë në krye të detyrave dhe obligimeve dhe të bëjnë gjithë çfarë është e mundur që të jenë sa më efikas në punën e tyre.

Çështja e dytë e diskutuar ndërlidhet drejtpërdrejt me zbatimin në praktikë të marrëveshjeve për **menaxhimin e integruar të kufirit**.

Lidhur me këtë çështje ne jemi pajtuar që zbatimi në praktikë i IBM-së të fillojë në muajin dhjetor dhe atë në katër vendkalime kufitare: Bërnjakë, Jarinjë, Merdar dhe te pika kufitare Dheu i Bardhë. Ndërsa, sa u përket dy pikave kufitare tjera, zbatimi i IBM-së do të fillojë në periudhë të mëvonshme, për shkak se në këto vendkalime kufitare aktualisht nuk ka qarkullim të mallrave, por vetëm të udhëtarëve dhe gjësendeve personale.

Në fazën e mëvonshme, Bashkimi Evropian është zotuar se do ta financojë ndërtimin e vendkalimeve kufitare të përbashkëta, për zbatimin sa më efikas të IBM-së.

Vendkalimet e përhershme të financuara nga Bashkimi Evropian pritet të ndërtohen në zonat neutrale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Lidhur me këtë çështje, më lejoni ta sqaroj edhe një element që ndërlidhet drejtpërdrejt me rolin e EULEX-it në këto pika kufitare. EULEX-i do t'i ushtrojë funksionet e tij në përputhje me mandatin e dhënë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mënyrë të njëjtë në të gjitha pikat kufitare.

Çështja e tretë që është adresuar në takimin e dytë ndërlidhet drejtpërdrejt me nevojën e hapjes së **zyrave ndërlidhëse** ndërmjet dy shteteve.

Për shkak të nevojave të shumta që kanë qytetarët e Kosovës dhe qytetarët e Serbisë dhe me qëllim të krijimit të kanaleve zyrtare të komunikimit ndërshtetëror, për t'i adresuar problemet e ndryshme, është shumë logjike dhe praktike që Republika e Kosovës të hapë zyrë ndërlidhëse në Beograd dhe të njëjtën gjë ta bëjë edhe Serbia në Prishtinë.

Hapja e zyrave ndërlidhëse do të ofronte edhe shërbime për pajisjen e qytetarëve me dokumente udhëtimi, dokumente të gjendjes civile.

Pikë e katërt, që është diskutuar në takimin e dytë, është çështja që ndërlidhet me domosdoshmërinë e **transparencës së Serbisë për financimin e sektorëve të ndryshëm në Kosovë**, e me theks të veçantë në financimin e strukturave paralele të sigurisë në veri të vendit. Ndalimi i financimit dhe zhbërja e strukturave ilegale të sigurisë të Serbisë, që funksionojnë ende në veri të vendit, është çështja kryesore dhe më e rëndësishme që ndërlidhet me këtë proces.

Ne mendojmë se Serbia mund të vazhdojë financimin e saj për komunitetin serb që jeton në Kosovë, por këtë duhet ta bëjë në mënyrë transparente dhe ndihma financiare duhet të kalojë nëpërmjet Buxhetit të Kosovës, e nga aty të shpërndahet te komunitatet me shumicë serbe, siç është planifikuar dhe përfshirë në dokumentin e presidentit Ahtisari.

Çështja e pestë që është diskutuar në këtë takim ndërlidhet me **masat për ruajtjen e trashëgimisë religjioze dhe kulturore serbe në Kosovë**. Në këtë aspekt, ne jemi të vetëdijshëm për suksesin e konsideruar që e kemi arritur bashkërisht dhe gjendja është përmirësuar dukshëm. Mirëpo, komuniteti serb ende i ka shqetësimet e veta, e që kryesisht ndërlidhen me mbrojtjen fizike të kishave, manastireve dhe objekteve tjera të rëndësishme. Për të ofruar siguri shtesë, unë kam propozuar krijimin e një njësie të veçantë në kuadër të Policisë së Kosovës, e cila do të merret me ruajtjen e këtyre objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore.

Çështja e gjashtë që është diskutuar dhe jemi pajtuar ka të bëjë me ndërtimin e një projekti të përbashkët infrastrukturor, i cili do të financohet nga Bashkimi Evropian. Fjala është për idenë tonë për **ndërtimin e autostradës Prishtinë-Merdar-Nish, apo Prishtinë-Mutivodë-Leskoc**.

Komisioni Evropian ka pranuar që ta financojë studimin e fizibilitetit për ndërtimin e kësaj autostrade. Ndërtimi i kësaj autostrade do t'ia hapte edhe një portë shtetit të Kosovës për t'u lidhur me korridorin evropian.

Dua të ju siguroj që tërësia territoriale e Republikës së Kosovës është e pacenueshme dhe e njohur ndërkombëtarisht, dhe si e tillë nuk është, nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë në tryezën e diskutimeve.

Lidhur me fjalimin e kryeministrit diskutuan: **Arsim Bajrami**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ismet Beqiri**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Glauk Konjufca**, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re dhe deputetët: **Rada Trajković, Shaip Muja, Skender Hyseni, Albin Kurti, Goran Marinković, Ramiz Lladrovci, Vjosa Osmani, Rexhep Selimi, Halit Krasniqi, Lutfi Haziri, Visar Ymeri, Flora Brovina, Arben Gashi, Afrim Kasolli, Hydajet Hyseni, Hashim Deshishku, Ganimete Musliu, Fadil Demaku, Zenun Pajaziti** dhe zëvendëskryeministrja **Edita Tahiri**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin e propozuar nga deputeti Ramë Vataj dhe grupi i deputetëve nënshkrues dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryesuesi e ftoi propozuesin që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin.

Deputeti Ramë Vataj, në cilësinë propozuesit, para deputetëve të Kuvendit e arsyetoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe i ftoi ata që ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Idriz Vehapi, tha se Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/19 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe i rekomandohet Kuvendit që të mos e miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/19 për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Pastaj, kryesuesi e hapi diskutimin lidhur me këtë projektligj.

Në emër të Grupeve Parlamentare diskutuan: Idriz Vehapi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, Milivoje Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe në cilësinë e deputetit: Aurora Bakalli, Muhamed Mustafa dhe Hydajet Hyseni, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----16,
Kundër -----45,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash:

V E N D O S I

1. Kuvendi nuk e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/19 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

2. Ngarkohet Qeveria e Republikës së Kosovës për hartimin e Projektligjit të ri për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës brenda tre muajve.

Deputeti Elmi Reçica propozoi që Kuvendi t'i ndërpresë punimet e mbledhjes së sotme, për t'i vazhduar një ditë tjetër.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e deputetëve lidhur me propozimin e deputetit Elmi Reçica.

Kryesuesi, me pëlqimin e deputetëve, i mbylli punimet e mbledhjes së sotme.

E enjte, 22 nëntor 2012

Vazhdimi i mbledhjes plenare

Kryetari konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm 65 deputetë dhe i hapi punimet e Kuvendit.

Ai i njoftoi deputetët se mbledhja plenare e Kuvendit, e filluar më 16 nëntor, pasi i ka shqyrtuar tri pikat e rendit të ditës, i ka ndërprerë punimet për t'i vazhduar sot, më 22 nëntor 2012.

Në ndërkohë, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 nëntor 2012, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, ka vendosur që kësaj seance t'i shtohen edhe dy pika të rendit të ditës:

- 1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor dhe*
- 2. Shqyrtimi i raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrime evropiane për vitin 2012*

Kryetari kërkoi deklarinimin e deputetëve për propozimin e shënuar më lart.

Kuvendi me shumicë absolute vendosi që në rend dite të seancës së sotme të përfshihen edhe dy pikat e lartshënuara.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Ministri **Hajredin Kuçi** tha se ky Projektligj ka për qëllim eliminimin e pengesave dhe mangësive të ligjit ekzistues të evidentuara nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, me ç'rast është bërë një qartësim i dispozitave rreth mënyrës së funksionimit të institucioneve përgjegjëse për ekzekutimin e sanksioneve penale, me qëllim të arritjes së efektit të qëllimit të dënimit.

Më tej, ministri theksoi se sipas dispozitave të këtij projektligji përcaktohet njësi ekonomike, e cila funksionon në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, po ashtu përcaktohen dispozita për kategorinë e personave të paraburgosur, si dhe rregullon në mënyrë të specifikuar personelin e Shërbimit Korrektues dhe të atij Sprovues, si dhe një ndarje dhe kategorizim i institucioneve korrektuese në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim, ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Haki Demolli, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re dhe Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 75,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funkcional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Ministri Nenad Rashiq tha se ky Projektligj e rregullon sigurinë dhe shëndetin në punë, e cila është pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës, duke ndërmarrë masat që kanë si synim përmirësimin e kushteve gjatë procesit të punës, ruajtjen e jetës, integritetin e shëndetit, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarve që marrin pjesë në procesin e punës. Ai më tej tha se sistemi i sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe korniza ligjore e cila e mbulon fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë në vendin tonë është e jo e plotë dhe e paimplementuar në tërësi, e për më tepër e largët nga standardet dhe legjislacioni evropian.

Ministri po ashtu theksoi se përafrimi i legjislacionit nacional me legjislacionin e BE-së nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë është kërkesë dhe nevojë e aspiratave tona, si për sigurinë e të punësuarve, ashtu edhe për detyrimin tonë për t'u bashkuar në BE. Për këto dhe arsye tjera, është i rëndësishëm hartimi dhe aprovimi i Ligjit të ri për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në vazhdim, ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Fikrim Damka, në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Thaçi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gëzim Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Milivoje Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Xhevahire Imaku, Rita Hajzeraj-Beqaj, Aurora Bakalli, Hashim Deshishku, Haki Demolli, Salihe Mustafa, Lutfi Zharku dhe ministri Nenad Rashiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 70,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision Funkcional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqes dhe ta arsyetojë Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera.

Ministri Memli Krasniqi tha se ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr.03/L-056 për ansamblin kombëtar shtetëror të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera është më se i nevojshëm, sepse gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji janë paraqitur probleme të shumta.

Më tej, ministri theksoi se me hartimin e draftit të ri të Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota”, si dhe për ansamblet tjera synohet të krijohet një ligj funksional dhe praktik, i cili do të ndikojë në avancimin e kornizës ligjore të kësaj fushe.

Hartimi i Projektligjit të ri nëpërmjet plotësimeve dhe ndryshimeve do të qartësojë kuptimin e ligjit dhe do të ndikojë në implementimin e synimeve të Qeverisë për avancimin e kulturës si prioritet të saj.

Në vazhdim, ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Idriz Vehapi, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lirije Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Vsirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Militoje Stojanoviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Vjollca Krasniqi, Bekim Haxhiu, Teuta Haxhiu, Sadri Ferati, Emilija Rexhepi, Lutfi Haziri, Blerta Deliu-Kodra dhe ministri Memli Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ansamblin kombëtar të këngëve dhe valleve “Shota” dhe për ansamblet tjera.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision FunkSIONAL dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës paluajtshme të Komunës.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e paraqiti deputeti Idriz Vehapi.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim amendamentin e vetëm.

Kuvendi e miratoi amendamentin 1 dhe të vetëm të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin me amendamentin e miratuar, në tërësi. Në sallë ishin të pranishëm 63 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 51,
Kundër ----- 6,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, tha se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 12 nëntor 2012, ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në mbledhjen e sotme plenare t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve.

Në vazhdim, kryesuesi i ftoi kryetarët /përfaqësuesit/ e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc.

Pas propozimeve të grupeve parlamentare, kryetari e hodhi në votim miratimin e Komisionit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 58,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, në këtë përbërje:

1. Behar Selimi nga GP PDK, kryesues,
2. Ramë Vataj nga GP PDK, anëtar,
3. Lirije Kajtazi nga GP LDK, anëtare,
4. Sadri Ferati nga GP LDK, anëtar,
5. Alma Lama nga GP "Vetëvendosje", anëtare,
6. Teuta Haxhiu nga GP AAK, anëtare,
7. Jeton Svirca nga GP Koalicioni Kosova e Re, anëtar,
8. Milivoje Stojanoviq nga GP SLS, anëtar,
9. Fikrim Damka, nga GP "6+", anëtar.

II. Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media që të veprojë në përputhje me nenin 11, paragrafi 2.3 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Media dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqes dhe ta arsyetojë Projektligjin për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Ministri Bedri Hamza tha se ky Projektligj përcakton mallrat të cilat lirohen nga taksa doganore dhe që mund të lëshohen në qarkullim të lirë me shkallën zero të taksës doganore për arsye të natyrës së mallit dhe për arsye të përdorimit të tyre të veçantë.

Më tej, ministri theksoi se zgjerimi i listës së produkteve të liruara nga taksa doganore, që vjen si rezultat i kërkesave të vazhdueshme nga bizneset, pritet të ketë ndikim pozitiv në ambientin e të bërit biznes në Republikën e Kosovës. Në masë të konsiderueshme besohet se do të ndihmohen në veçanti bizneset prodhuese, pasi këto masa kryesisht janë të ndërlidhura me lirimet e lëndëve të para, me ç'rast do të zvogëlohet kostoja e prodhimit vendor. Në të njëjtën kohë, nëpërmjet këtyre masave pritet të ndikohet në përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës, duke e rritur zëvendësimin e produkteve të importit me prodhime vendore, si dhe të nxitet punësimi i qëndrueshëm në këtë sektor.

Në vazhdim, ai u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safet Hadërgjonaj, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Muhamet Mustafa, Ali Sadriu, Ramiz Kelmendi, Mursel Haljilji, Hamza Balje, si dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision FunkSIONAL dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i Raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritime evropiane për vitin 2012

Në emër të Komisionit për Integritime Evropiane, Lutfi Haziri tha se në këtë raport janë përfshirë të arriturat dhe sfidat e institucioneve të Republikës, që përfshijnë kriteret politike, fushën e demokracisë dhe të sundimit të ligjit, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve, çështjet rajonale dhe obligimet ndërkombëtare, kriterin ekonomik, fushën e ekzistencës së ekonomisë së tregut dhe kapacitetet për ta përballuar presionin konkurrues dhe forcën e tregut brenda Unionit dhe në standardet evropiane në fushën e tregut të brendshëm, politikat sektoriale, si drejtësia, liria dhe siguria.

Kuvendi në këtë raport ka shënuar progres në një varg çështjesh, duke krijuar komisione pune, angazhime konkrete dhe miratim për reformën kushtetuese dhe zgjedhore, si pjesë e kriterëve që Komisioni Evropian i ka bërë për Kosovën; pastaj dëgjimet publike të ministrave të linjës, raportimin e tyre, miratimin e legjislacionit të kërkuar sipas Raportit të Progresit 2011, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe kërkohet edhe më tutje të rriten kapacitetet për monitorim.

Komisionet parlamentare në progresin e arritur kanë paraparë që ta rritin mbikëqyrjen në zbatimin së paku të një ligji për kalendarin vjetor.

Megjithatë, progres i limituar mbetet në sundimin e ligjit dhe më tutje mbetet sfida kryesore, që përfshin veriun e Kosovës dhe funksionalizimin e sistemit gjyqësor.

Rekomandimi final i Komisionit për Integritime Evropiane është që duhet të rishikohet roli i Kuvendit të Republikës së Kosovës në këtë agjendë. Meqë Kuvendi merr pjesë në të gjitha mekanizmat, institucionet që merren me integritime evropiane, ne propozojmë që roli i Kuvendit në të ardhmen, nga janari i vitit të ardhshëm, të jetë roli i mbikëqyrësit të zbatimit të planit nacional dhe planeve sektoriale për integritime evropiane, duke i rritur kapacitetet e komisioneve, në mënyrë që të mbikëqyret, të monitorohet dhe të kontrollohet puna e Ekzekutivit si bartës i procesit të integritimeve evropiane.

Edhe më tutje Kuvendi është peng i autonomisë buxhetore, i cili është kërkuar nga Komisioni Evropian. Duhet të definohet qartë çka nënkuptohet me autonomi buxhetore, cili është roli i Kuvendit si bartës i këtij institucioni dhe angazhimet konkrete, në mënyrë që raporti financiar dhe roli ynë të përmirësohet.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritime evropiane, për vitin 2012.

Lidhur me Raportin e tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrime evropiane për vitin 2012 diskutuan: Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion, Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Halit Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e raportit të tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrime evropiane për vitin 2012.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 55,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti i tretë për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integrime evropiane për vitin 2012 me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Kryesuesi i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 13:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale